



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	05.11.2020	06.11.2020	886/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.11.2020, OE "E-Tech Sh.p.k." - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 886/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Softwer per Backup - retender" me nr. të prokurimit: 318-20-6112-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 12,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

#### Dispozitat e shkelura

Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 66 te LPPse; Piken 39. Sqarimi i Tenderëve te RRUOPP, pikën 39.3 te RRUOPP, Piken 39. 5 dhe 45.4 te RRUOP.

#### Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues ka derguar me date 26.10.2020 permes platformes se e-prokurimit, Letren Standarde per vendim ANULIMI te procedures se prokurimit Për Aktivitetin e Prokurimit: 318-20-6112-1-2-1 Sa i perket tenderit per Furnizim me Software per Backup -retender, pasi ofe rta e pranuar nuk i ka plotesuar kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Ne dokumentin e eliminimit AK pretendon si ne vijim- citat:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "E-Tech Sh.p.k." - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Softwer per Backup - retender", me numër të prokurimit: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE



Tenderi juaj është i papergjegjshëm sepse:

Administrativisht: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë garancion 3 vjeçarë për të gjitha zgjidhje (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar. Dokumenti i ofruar nga OE E-Tech SHPK nuk e plotëson kërkesën dhe deshmimet e kërkuar në dosje të tenderit, andaj kualifikohet i papergjegjshëm.

AK ka publikuar me datë 26.10.20 në portalin E-Prokurimi të Republikës së Kosovës njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Nëse OE, kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim me datën 27.10.2020 ku kemi paraqitur faktet tona se me këtë anulim është jehur disa nënë të LPP dhe rrjedhimisht jemi si pale e demtuar .

AK, me datën 29.10.2020, ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim me arsyetimin se nuk është e mundur të eliminim.

Nëse OE E-Tech SHPK, në vijim të bashkangjesim edhe njëher faktet për këtë procedurë Prokurimi:

Nëse OE jemi duke shfrytëzuar të drejtën tonë për ankesë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi në Republikën e Kosovës. Në shprehim kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit të AK, duke pretenduar se janë bërë shkelje të dispozitave të LPP në fuqi siç është cekur në pikën 6 të kësaj kerkese.

-Në mendojmë se vlerësimi i ofertës tonë nuk është kryer sipas LPP dhe arsyeja e eliminimit është i pa bazuar. Nuk është aplikuar LPP, specifikisht tek Pika 39. Sqarimi i Tenderëve të RRUOPP ku AK, ka mund të deshmoj saktësinë e Deshmive që janë leshuar nga Prodhuesi/Distributori. Në mendojmë se oferta jonë i ka plotësuar të gjitha kërkesat administrative dhe teknike ku deshmohet dhe hidhet poshtë pretendimi që nuk kemi ofruar Garancion për (Hardware dhe Software).

Sipas LPP, AK ka mundësi që dokumentet e dërguara të verifikoj direkt me prodhuesin dhe distributorin, ndërsa ka vepru njëanshëm dhe pa asnjë bazë nuk i ka pranuar si deshmim valide.

Në vijim po japim shpjegime që deshmimet e kërkuar janë pjesë e ofertës sonë.

Sipas LPP dhe RRUOPP-se, pika 45.4, AK nuk ka caktuar formatin që OE duhet të përdorin si deshmim dhe si e Autorizim nga prodhuesi. Andaj rrjedhimisht, nëse OE, tek Prodhuesi dhe Distributori i autorizuar kemi kërkuar që Autorizimet të leshohen sipas standardeve që kanë. Andaj, në ofertën tonë, i kemi bashkangjitur këto dokumente që deshmojnë se oferta jonë ka Garancionin e përfshirë dhe po ashtu ka edhe deshmimet e kërkuara.

Dokumentet që deshmojnë se oferta jonë i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes janë:



1. Aneksi 1 i Specifikacionit teknik - paragrafi 4 perfshre listen e produkteve qe jane pjese e ofertes (Garancioni 3 vite per Hardware dhe Software), lista e produkteve eshte ofruar me PN.

Ne vijim mund te gjeni pjese nga ANEKS 1 ku deshmoheq qe garancioni eshte pjese e ofertes.

Hyper-v, Red Hat Enterprise Linux, SUSE Linux Enterprise Server, VMware® ESXi	Linux Enterprise Server, VMware® ESXi
The server should be supplied with manufacturer's authorization and warranty obligations within a three-year warranty period from the date of acceptance from end user.	The server is supplied with manufacturer's authorization and warranty obligations within a three-year warranty period from the date of acceptance from end user.

#### 4.1.1. Lista e Produkteve te Ofruara (Bill of Quantity)

Description		Qty
PowerEdge R440 Server [PowerEdge R440 - Full Configuration - [EMEA_R440_VI_VP]]		1
Components		
338-BSDV	Intel Xeon Bronze 3204 1.9G, 6C/6T, 9.6GT/s, 8.25M Cache, No Turbo, No HT (85W)	2
321-BCUV	2.5" Chassis with up to 8 Hot Plug Hard Drives	1
325-BCHH	Standard Bezel	1
330-BBHO	Riser Config 3, 2 x 16 LP	1
350-BBKT	Dell EMC Luggage Tag	1
370-AAIP	Performance Optimized	1
370-AEVR	3200MT/s RDIMMs	1
370-AEVQ	16GB RDIMM, 3200MT/s, Dual Rank	2
385-BBLD	iDrac9, Basic	1
400-BDSS	240GB SSD SATA Mixed Use 6Gbps 512e 2.5in Hot Plug S4610 Drive	2
405-AAOM	Internal PERC	1
405-AAOE	PERC H730P RAID Controller, 2GB NV Cache, Adapter, Low Profile	1
412-AAJT	Standard Heat Sink	1
412-AAJU	Standard Heat Sink for 2nd CPU	1
450-AGOY	Dual, Hot Plug, Redundant Power Supply (1+1), 550W	1
450-AADY	C13 to C14, PDU Style, 10 AMP, 6.5 Feet (2m), Power Cord	2
461-AAEL	Trusted Platform Module 1.2	1
293-10025	Asset Tag - ProSupport (Website, barcode, Onboard MacAddress)	1
389-DSXY	PowerEdge R440 CE,CCC,BIS Marking	1
542-BBCR	Dual-Port 1GbE On-Board LOM	1
770-BCKT	ReadyRails Sliding Rails With Cable Management Arm	1
Software		
384-BBSL	Performance BIOS Settings	1
384-BCHR	PowerEdge R440 MLK Motherboard V2	1
619-ABVR	No Operating System	1
Service		
709-BBIX	Parts Only Warranty 36 Months	1

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "E-Tech Sh.p.k." - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Softwer per Backup - retender", me numër të prokurimit: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE



Machines	License kit supports minimum 25 Virtual Machines
Software Solution should be supplied with manufacturer's authorization and warranty obligations within a three-year warranty period from the date of acceptance from end user	Software Solution will be supplied with manufacturer's authorization and warranty obligations within a three-year warranty period from the date of acceptance from end user

#### 4.2.1. Lista e Produkteve të Ofruara (Bill of Quantity)

Quantity	Product SKU	Veem Product Description	Comment
5	V-ESSVUL-01-SU3YP-00	Veem Backup Essentials Universal License. Includes Enterprise Plus Edition features - 3 Year Subscription Upfront Billing & Production (24/7) Support	Universal license, sold by bundles of 5, minimum purchase of 2 bundles, maximum purchase 10 bundles. 2-bundle minimum qualification may include a purchase of a New License SKU and a Subscription Renewal SKU (New License and Subscription Renewal must be co-termed). Includes VM, Server or Workstation Agents, Cloud VM or App Plug-In SAP/Oracle and NAS.

#### 4.2.2. Garancioni i harduerit dhe softuerit

Të gjitha pajisjet harduerike dhe softuerike të ofruara përfsijnë garancinë e prodhuesit në një periudhë kohore prej 3 viteve.

Në tabelën vijuese janë paraqitur detajet e garancisë të pajisjeve harduerike që ofrohen nga prodhuesi:

Warranty services & support Details	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Warranty - replacement - response time: next business day 8x5,</li> <li>• Technical support - phone consulting</li> <li>• Technical support - web support</li> </ul>
-------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

2. Deklarata e Specifikacionit teknik nga E-Tech
3. Deklarata nen Betim nga E-tech
4. MAF - Autorizim i nga prodhuesir DELL Technologies.
5. Dëshmi per Garancion sipas formatit te Prodhuesit nga Distributori per DELL
6. MAF dhe dëshmi per Garancion nga prodhuesi VEEAM.

Sqarim:

Ne lidhje me Garancionet e pajisjeve ju ofrojme informata qe, nje Pajisje nuk mund ti aktivizohet garancioni nese pajisja nuk eshte prodhuar, andaj si proces eshte se, ne kemi Autorizim nga Distributori dhe Prodhuesi per te ju shitur Produktin dhe Garanconin sipas Listes me PN qe eshte ne oferte. Pasi te leshohet porosia dhe pasi ne te bejme liferimin e pajisjeve tek AK, do ju ofrohet edhe qasje ne sistem te Prodhuesve ku do te keni mundesi te vertetoni qe pajisjet Hardware dhe Software



kane garancion valid te prodhuesit me kohezgjatje 3 vjeqa re. Informata per kete verifikim, jane prezantuar edhe ne deshmite per Garancion qe kemi prezantuar ne deshmite e ofruara nga prodhuesi/distributori.

Duke ju referuar ofertes tone administrative dhe teknike dhe ketij shpjegimi me larte, ne si OE mendojme se kemi fakte te padiskutueshme te cilat jemi ne gjendje t'i mbrojme ne cdo instance, se oferta jone e dorezuar per kete procedure prokurimi eshte plotesisht ne pajtim me kerkesat e dosjes se tenderit dhe ne harmoni te plote me te gjitha dispozitat e LPP-se dhe RRUPP-se.

Prandaj, eliminimi i E-Tech per arsyet e siper permenduara administrative dhe teknike eshte i pasakte dhe ne kundërshtim me ligjin e Prokurimit Publik.

Perfundimisht, ne arsyet e eliminimit te ngritura nga AK, OE E-Tech SHPK permes fakteve te detajuara dhe te konfirmuara nga prodhuesit dhe distributor ka ofruar dokumentet e nevojshme per te garantuar se produktet kane 3 vite garancion nga prodhuesi dhe jane ne perputhshmeri te plote nga ato te kerkuara sipas dosjes se tenderit.

Kerkojme nga OSHP qe te marr per baze ankesen tone dhe ta konsideroje oferten tone ne perputhshmeri te plote me kerkesat teknike, funksionale dhe profesionale te kerkuara ashtu sic u deshmua me larte dhe sic mund te konfirmohet drejtperdrejte me prodhuesit kurdo qe OSHP e sheh te arsyeshme.

## KRITERET PËR VLERËSIM

### Kërkesat

1. Operatori Ekonomik duhet te ofroje 6 muaj mirëmbajtje dhe përkrahje shtese pas raportit final te projektit per te gjitha instalimet dhe konfigurimet e kryera.
2. Operatori Ekonomik është i obliguar te ofroje plan te detajuar (Project Work Plan) te implementimit, konfigurimit dhe integritit te zgjidhjes.
3. Operatori Ekonomik duhet te ofroje garancion 3 vjeçare për te gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar.
4. Operatori Ekonomik është i obliguar te ofroje Autorizimin e Prodhuarit (Manufacturer Authorization) ose nga distributori i autorizuar për te gjitha pajisjet (Hardware dhe Software).
5. Deklaratë me shkrim mbi plotësimin e specifikave teknike
6. Dëshmi me shkrim mbi afatin e liferimit
7. Lista e referencave te furnizimeve te ngjashme ne tri vitet e fundit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "E-Tech Sh.p.k." - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Softwer per Backup - retender", me numër të prokurimit: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE

### Dëshmia dokumentare

1. Te dëshmohet me deklaratë me shkrim
2. Dëshmi me shkrim
3. Te dëshmohet me deklaratë me shkrim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar
4. Te dëshmohet me deklaratë me shkrim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar
5. Deklaratë me shkrim nga ofertuesi
6. Dëshmi me shkrim mbi afatin e liferimit
7. Te dëshmohet me referenca

### **RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES**

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

*Operatori Ekonomik duhet te ofroje garancion 3 vjeçare për te gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar. Dokumenti i ofruar nga OE ETech SHPK nuk e ploteson kërkesen dhe dhesmine e kerkuar ne Dosje te tenderit, andaj kualifikohet i papegjegjshem.*

### **INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK**

Nuk ka

### **VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së**

N/A

### **VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME**

N/A



## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "E-Tech Sh.p.k." - PRISHTINË

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me disa nga arsyet e eliminimit të dhënë nga AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, të dërguar me datë 26.10.2020.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor

Lidhur me garancion 3 vjeçar për te gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar.

OE bazuar në dokumentet e dorëzuara përmes sistemit të E-Prokurimit (03.MAF dhe garancioni nga prodhuesi; DELL Technologies - Deklarata e Garancionit; DELL Technologies – MAF; Veeam - MAF dhe Garancioni nga prodhuesi), ka plotësuar dëshmitë dokumentare të kërkuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Ndërsa, lidhur me vlerësimin nga AK se këto dokumente nuk plotësojnë kërkesën dhe dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit, kjo nuk është në harmoni me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikës 39 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), ku kërkohet që AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit".

Meqenëse, sipas komisionit dokumentet e tilla nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes e tenderit, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i drejtë, është dashur që me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, të kërkohej sqarime shtesë nga OE dhe vlerësimi i ofertës mund të vendosej vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve ne pyetjet e kërkuara nga AK dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe propozohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- |                           |                                                |
|---------------------------|------------------------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE |
| - Panelit Shqyrtues       | - OSHP                                         |
| - OE ankues               | - "E-Tech Sh.p.k."                             |